**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE**

# RELACION SHPJEGUES

## 1. PËRMBAJTJA E RAPORTEVE TË MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR – GUSHT 2026

- ANEKSI nr 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"

  ANEKSI nr.2 "Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit"
- ANEKSI nr.2.1 "Shpenzimet e Programit sipas kapitujve"
- ANEKSI nr.3 "Raporti I performances së produkteve të programit"
- ANEKSI nr.3.1 "Raporti performances së produkteve të programit sipas artikujve"
- ANEKSI nr.3.2 "Devijacioni I kostos për njësi në vite"
- ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit të treguesve të performancës të programit"
-

## 2. HYRJE

Në zbatim të Shtojcës nr.3, të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore", paraqesim në mënyrë të përmbledhur procesin e monitorimit të kryer gjatë periudhës Janar-Gusht 2026, si në vijim:

Programi Shërbimet për çështjet e birësimeve në përmbushje të politikës së programit të vet ka kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, Ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", si dhe udhëzimet plotësuese të Ministrit të Financave Nr.2, dt.14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026" dhe Ekonomisë në zbatim të tij.

EMP me në krye DEMP ka realizuar në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e performancës së programit, konkretisht të politikës së programit, si dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore në funksion të saj për të gjithë artikujt kontabël përkatës. Paralelisht është bërë edhe monitorimi i buxhetit dhe nivelit të shpenzimeve në përputhje me produktet e realizuara.

## 3. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Gjatë periudhës raportuese, në zbatim të, Ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026" në zbatim të udhëzimit të ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" si dhe Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.2, dt.14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", janë rialokuar fonde buxhetore brenda programit. Konkretisht:

a. Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, Nr. 491/2 prot., datë 13.02.2026, "Dërgohet miratimi i transferimit të fondit për vitin 2026", vlera prej 24.000 lekësh u pakësua nga llogaria ekonomike 602 "Mallra dhe shërbime" dhe u shtua në llogarinë ekonomike 606 "Transferta për buxhete familjare dhe individë". Këto fonde, sipas pikës 14 të VKM nr. 673/2020, përdoren për kompensimin e titullarit të institucionit për shërbimin e telefonisë celulare.

b. Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, Nr. 492/2 prot., date 13.02.2026, "Dergohet miratimi i detajimit te fondit te veçantë për vitin 2026", për institucionin tonë është miratuar detajimi i buxhetit për fondin e veçantë në vlerën 100.000 lekë për vitin 2026.

c. Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, Nr. 1875/5 prot., datë 17.04.2026, "Dërgohet detajimi i limitit mujor për shpenzimet kapitale për vitin 2026", , për institucionet në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, përfshirë edhe institucionin tonë, është miratuar zbatimi i projektit 18AR302 "Pajisje elektronike të blera", në vlerën 100.000 lekë dhe projektit 18AR303 "Blerje Paisje per zyra", në vlerën 100.000 lekë për vitin 2026. Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Fianciar,Ministria e Drejtësise Nr.4557/1 prot dat 29.07.2026 "Mbi zbatimin e aktit normativ Nr.2, datë 30.06.2026 për shpenzimet kapitale" u bë transferimi i fondit të shpenzimeve kapitale nga projektit 18AR303 "Blerje Paisje per zyra", 100,000 leke ne zërin e projektit 18AR302 "Pajisje elektronike të blera" i cili bëhet 200,000 lekë.

ç. Me shkresën Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Fianciar, Ministria e Drejtësise Nr.4557 prot dat 28.07.2026" Mbi zbatimin e aktit normativ Nr.2, datë 30.06.2026 për shpenzimet korrente" u miratua shtesë fondi për produktin 91404AA "Kërkesa për birësim të shqyrtuara "në fondin e pagave prej 4,600,000 lekë dhe sigurimeve shoqerore e shendetesore 750,000 leke.

Numri I punonjësve sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri nr.134 Prot. datë 23.11.2021 dhe strukturës së fundit të miratuar nga Kryeministri me kategoritë e ndryshuara Nr.247/2 prot datë

13.02.2026, "Detajimi i numrit te punonjësve organik për vitin 2026", për Insitucionin tonë, për periudhën Janar- Dhjetor 2026 është 9 punonjës së bashku me Kryetarin e KSHB. Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Fianciar Ministria e Drejtësise Nr.389/2 prot dat 06.02.2026 "Miratimi i detajimit të punonjësve me kontratë për vitin 2026" miratohen 3 operatore 6 orarësh per vitin 2026. Gjithashtu pozicioni i Specialist (Jurist) – me kategori page IV-2 u plotësua me proçeduren "Lëvizje paralele" të Specialistit te Arkivë Protokollit kategori page IV-3. Pozicioni në organikë i Specialistit te Arkivë Protokollit kategori page IV-3 mbetet vakant. Ne 24 Shkurt te 2026 nga Programi Thirrja e X e praktikave te punës janë punësuar me kontrat 1 vjecare "Specialist pranë arkivë protokollit" dy punonjëse Znj. AH dhe Znj. BGJ dhe nje punonjës "Specialist jurist" Z. DL.

## 4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

1. Programi "Shërbimet për Çështjet e Birësimeve"

Shpenzimet buxhetore për 8-mujorin e parë të vitit 2026, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, janë realizuar në masën 56%. Realizimi sipas zërave kryesorë rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit.....56.3%
- Shpenzimet operative.....60%
- Shpenzime kapitale.....0%

Buxheti fillestar i akorduar me Ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", për programin "Shërbimet për Çështjet e Birësimeve", ishte 19,310,000 lekë. Gjatë periudhës raportuese janë kryer ndryshime brenda zërave buxhetorë, konkretisht me shkresën nr. 1120/1 prot., datë 07.04.2026 të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, është transferuar fondi prej 24,000 lekësh nga llogaria ekonomike 602 "Mallra dhe shërbime" në llogarinë ekonomike 606 "Transferta për buxhete familjare dhe individë", për kompensimin e telefonisë celulare të titullarit të institucionit, sipas VKM nr. 673/2020. Gjithashtu është miratuar fondi i veçantë në vlerën 100,000 lekë. Me shkresën Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Fianciar, Ministria e Drejtësise Nr.4557 prot dat 28.07.2026" Mbi zbatimin e aktit normativ Nr.2, datë 30.06.2026 për shpenzimet korrente" shtesa në llogarinë ekonomike 600 "Paga" prej 4,600,000 lekë dhe në llogarinë ekonomike 601 "Sigurimeve shoqerore e shendetesore" 750,000 leke.

Plani i rishikuar për programin është 24,760,000 lekë.

Shpenzimet e personelit, nga 21,020,000 lekë të planifikuara për llogaritë 600 dhe 601, janë realizuar në vlerën 11,846,691 lekë, ose rreth 56%. Konkretisht, për artikullin 600 "Paga" realizimi është 10,171,910 lekë nga 17,990,000 lekë të planifikuara, ndërsa për artikullin 601 "Sigurime Shoqërore" realizimi është 1,674,781 lekë nga 3,030,000 lekë të planifikuara.

Shpenzimet operative për artikullin 602 janë realizuar në vlerën 2,049,393 lekë nga 3,416,000 lekë të planifikuara, ose rreth 60 %, procedurat e prokurimit janë zhvilluar në kohë dhe një pjesë e shpenzimeve është kryer gjatë periudhës raportuese, pjesa tjetër do te realizohet në periudhat pasardhëse të vitit buxhetor. Gjithashtu janë realizuar pjesërisht shpenzimet për shërbime ndaj të tretëve dhe shpenzime administrative të institucionit.

Për artikullin 606 "Transferta për buxhete familjare dhe individë", plani i rishikuar është 124,000 lekë, ndërsa realizimi faktik është 13,800 lekë, ose rreth 11% e planit.

Për shpenzimet kapitale janë planifikuar 200,000 lekë për blerje pajisjesh elektronike dhe pajisje zyre. Gjatë 8-mujorit të parë të vitit 2026 është realizuar procedura e prokurimit brenda 8-mujorit vitit dhe realizimi financiar i shpenzimit kapital do të përfundojë në periudhën në vijim.

Programi "Shërbimet për Çështjet e Birësimeve" për vitin 2026 ka parashikuar produktin "Kërkesa për birësim të shqyrtuara". Nga 20 kërkesa të planifikuara për vitin 2026, gjatë 8-mujorit të parë janë shqyrtuar dhe realizuar procedurat për 15 raste birësimi. Institucioni ka vijuar punën për shqyrtimin

brenda afateve ligjore të të gjitha kërkesave të aplikantëve birësues dhe për realizimin e proceseve birësuese për fëmijët me dosje të depozituara në Komitetin Shqiptar të Birësimeve.

Gjatë periudhës Janar–Gusht 2026, institucioni është angazhuar maksimalisht në garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse, agjencitë ndërmjetësuese dhe institucionet e përkujdesit social, për realizimin e procedurave të birësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Buxheti fillestar i akorduar me Ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", për programin "Shërbimet për Çështjet e Birësimeve", ishte 19,310,000 lekë. Gjatë periudhës raportuese janë kryer ndryshime brenda zërave buxhetorë, konkretisht me shkresën nr. 1120/1 prot., datë 07.04.2026 të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë, është transferuar fondi prej 24,000 lekësh nga llogaria ekonomike 602 "Mallra dhe shërbime" në llogarinë ekonomike 606 "Transferta për buxhete familjare dhe individë", për kompensimin e telefonisë celulare të titullarit të institucionit, sipas VKM nr. 673/2020. Gjithashtu është miratuar fondi i veçantë në vlerën 100,000 lekë. Ministria e Drejtësise Nr.4557 prot dat 28.07.2026" Mbi zbatimin e aktit normativ Nr.2, datë 30.06.2026 për shpenzimet korrente" shtesa në llogarinë ekonomike 600 "Paga" prej 4,600,000 lekë dhe në llogarinë ekonomike 601 "Sigurimeve shoqerore e shendetesore" 750,000 leke. Plani i rishikuar për programin është 24,760,000 lekë.

Në Aneksin nr.2 paraqiten ekzekutimi I buxhetit në nivel programi sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas produkteve të programit buxhetor si më poshtë:

ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit

Periudha e Raportimit 08-2026

në/lekë

| Emri i Grupit | Ministria e Drejtësisë | Kodi i grupit | 14 |
|---|---|---|---|
| Emri i | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | Kodi i programit | 01160 |

| EMËRTIME | | Shpenzimet e Programit | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Viti paraardhës 2025 | | Periudha raportuese | | Periudha raportuese | | Periudha raportuese | Periudha raportuese | | Ndryshimi Vjetor ( Plan - Fakt) | % e realizimit |
| | | Shpenzime Faktike | Struktura e shpenzimeve në % | Plani Fillestar Vjetor Viti 2026 | Struktura e shpenzimeve në % | Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2026 | Struktura e shpenzimeve | Ndryshimi i planit vjetor | Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive | Struktura e shpenzimeve në % | | |
| Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik | | | | | | | | | | | | |
| Kodi i Programit | Emërtimi | | | | | | | | | | | |
| 600 | Paga | 10907893 | 73 | 13,390,000 | 69 | 17,990,000 | 73 | 4,600,000 | 10,171,910 | 73 | 7,818,090 | 57 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 1768526 | 12 | 2,280,000 | 12 | 3,030,000 | 12 | 750,000 | 1,674,781 | 12 | 1,355,219 | 55 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 2174241 | 15 | 3,440,000 | 18 | 3,416,000 | 14 | -24,000 | 2,049,393 | 15 | 1,366,607 | 60 |
| 603 | Subvencione | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | - | 0 | 0 | 0 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | - | 0 | 0 | 0 |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | - | 0 | 0 | 0 |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 24,872 | 0 | 0 | 0 | 124,000 | 1 | 124,000 | 13,800 | 0 | 110,200 | 11 |
| | **Nëntotali Shpenzime Korente** | **14,875,532** | **99** | **19,110,000** | **99** | **24,560,000** | **99** | **5,450,000** | **13,909,884** | **100** | **10,650,116** | **57** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 86,384 | 1 | 200,000 | 1 | 200,000 | 1 | 0 | 0 | 0 | 200,000 | 0 |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm** | **86,384** | **1** | **200,000** | **1** | **200,000** | **1** | **0** | **0** | **0** | **200,000** | **0** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj** | **0.00** | **0** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0.00** | 0 | 0 | 0 |
| | Totali i Shpenzimeve Kapitale | **86,384** | **0** | 200,000 | 1 | 200,000 | 1 | **0** | 0 | 0 | 200,000 | 0 |
| | Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit | **14,961,916** | **100** | 19,310,000 | 100 | 24,760,000 | 100 | **5,450,000** | 13,909,884 | 100 | 10,850,116 | 56 |
| | **Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)** | 0 | | | | | | | 0 | | | |
| | **Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)** | 0 | | | | | | | 0 | | | |
| | Totali i Shpenzimeve të Programit | 14,961,916.00 | | | | | | | 13,909,884 | | | |
| Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor | | | | | | | | | | | | |
| Artikulli | Emërtimi | | | | | | | | | | | |
| | Totali i Shpenzime Korente | 14,875,532.0 | 99 | 19,110,000 | 99 | 24,560,000 | 99 | 100,000 | 13,909,884 | 100 | 10,850,116 | 57 |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| 91404AA | Kërkesa për birësim të shqyrtuara | 14,961,916 | 99 | 19,110,000 | 99 | 24,560,000 | 99 | 100,000 | 13,909,884 | 100 | 10,850,116 | 57 |
| | Totali Shpenzime për Investime | 86,384 | 1 | 200,000 | 1 | 200,000 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| 18AR302 | Pajisje elektronike të blera | 86,384 | 1 | 200,000 | 1 | 200,000 | 1 | 0 | 0 | 0 | 200,000 | 0 |
| 18AR303 | Pajisje per zyra | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm** | **86,384** | **1** | **200,000** | **1** | **200,000** | **1** | **0** | **0** | **0** | **200,000** | **0** |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| | Totali i Shpenzimeve të Programit | 14,961,916 | | 19,310,000 | | 24,760,000 | | 100,000 | 13,909,884 | | 10,850,116 | |

Në Aneksin nr.2/1 paraqiten ekzekutimi I buxhetit në nivel programi buxhetor dhe realizimi i artikujve buxhetore në përqindje si më poshtë:

**RAPORTI 2/1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve**

Periudha e Raportimit 08-2026

| Kodi i Ministrisë | Kodi i Programit | Emërtimi i Programit | Kodi i Kapitullit | Emërtimi i Kapitullit | Periudha raportuese | Buxheti | Artikujt buxhetore | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | 230 | 231 | 600 | 601 | 602 | 603 | 604 | 605 | 606 | Total |
| | | | | | Periodike /Vjetore | | Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara | Shpenzime Kapitale të Trupëzuara | Pagat | Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore | Mallra dhe Shërbime | Subveci-net | Të Tjera Transfer.Korrente Brendshme | Transfer.Korrente të Huaja | Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individët | Total |
| 14 | 1160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 1 | Nga Buxheti | 2026 | Plani fillestar | 0 | 200,000 | 13,390,000 | 2,280,000 | 3,440,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 19,310,000 |
| 14 | 1160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 1 | Nga Buxheti | 2026 | Plani i rishikuar | 0 | 200,000 | 17,990,000 | 3,030,000 | 3,416,000 | 0 | 0 | 0 | 124,000 | 24,760,000 |
| 14 | 1160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 1 | Nga Buxheti | 2026 | Fakti | 0 | 0 | 10,171,910 | 1,674,781 | 2,049,393 | 0 | 0 | 0 | 13,800 | 13,909,884 |
| 14 | 1160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 1 | Nga Buxheti | 2026 | Angazhime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 1160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Total | 2026 | Plani fillestar | 0 | 200,000 | 13,390,000 | 2,280,000 | 3,440,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 19,310,000 |
| 14 | 1160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Total | 2026 | Plani i rishikuar | 0 | 200,000 | 17,990,000 | 3,030,000 | 3,416,000 | 0 | 0 | 0 | 124,000 | 24,760,000 |
| 14 | 1160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Total | 2026 | Fakti | 0 | 0 | 10,171,910 | 1,674,781 | 2,049,393 | 0 | 0 | 0 | 13,800 | 13,909,884 |
| 14 | 1160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Total | 2026 | Angazhime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 1160 | Ndryshimi ne vlere absolute | | | 2026 | | 0 | 200,000 | 7,818,090 | 1,355,219 | 1,366,607 | 0 | 0 | 0 | 110,200 | 10,850,116 |
| 14 | 1160 | Realizimi ne % | | | 2026 | | 0 | 0 | 57 | 55 | 60 | 0 | 0 | 0 | 11 | 56 |

Për llogarinë ekonomike 606 "Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë", plani vjetor i rishikuar është 124,000 lekë, ndërsa realizimi faktik është 13,800 lekë, me devijim 110,200 lekë nën plan dhe nivel realizimi 11%. Nënrealizimi lidhet me përdorimin faktik të kufizuar të fondit dhe mosshfrytëzimin e plotë të shumës së planifikuar gjatë periudhës raportuese.

Për llogarinë ekonomike 231 "Kapitale të Trupëzuara", plani vjetor i rishikuar është 200,000 lekë, ndërsa realizimi faktik është 0 lekë, me nivel realizimi 0% dhe devijim 200,000 lekë nën plan. Devijimi lidhet me faktin se, megjithëse procedura e prokurimit u realizua brenda 8-mujorit, likuidimi nuk u krye deri më 31 gusht 2026; ai do të pasqyrohet në muajin shtator 2026.

Në total, për periudhën 8-mujore të vitit 2026, shpenzimet buxhetore të programit janë realizuar në masën 56 %, me plan vjetor të rishikuar 24,760,000 lekë dhe realizim faktik 13,909,884 lekë, duke rezultuar në një devijim prej 10,850,116 lekë nën planin vjetor të rishikuar.

Numri I fëmijëve të birësuar vjen si pasojë e numrit të fëmijëve të braktisur te shpallur me Vendim Gjykate dhe birësimeve me pëlqim (ose me lidhje gjaku).

Konkretisht numri I fëmijëve ne KSHB lidhet drejtpërdrejt me numrin e dosjeve të depozituara.

Numri I dosjeve të fëmijëve të ardhur në KSHB në 8-mujorin e pare 2026 është 24 dosje, nga të cilat 6 janë të mbartur me dosjet e fëmijëve të ardhur nga vitet e mëparshme. Gjate 8-mujorit te pare 2026 jane birësuar 15 fëmijë.
Numri I fëmijëve të ardhur në KSHB në 2025 është 28 fëmijë, nga të cilat janë mbartur edhe dosjet e fëmijëve të ardhur nga vitet e mëparshme dhe jane birësuar 26 fëmijë
Numri I fëmijëve të ardhur në KSHB në 2024 është 17 fëmijë nga te cilet jane birësuar 12 fëmijë

**Për vitin 2026, deri në fund të 8-mujorit, janë birësuar 15 fëmije.**

Gjatë periudhës Janar- Gusht 2026, programi Shërbimet për çështjet e birësimeve, ka realizuar veprimtarinë e tij duke e mbështetur politikën e programit mbi një qëllim kryesor, konkretisht:

***Qëllimi*** – *Sigurimi dhe monitorimi i fëmijëve të mitur, të shpallur të braktisur me vendim gjykate, të birësuar nga familje shqiptare që jetojnë brenda ose jashtë vendit si dhe nga familje të huaja, duke garantuar dhe respektuar të drejtat e tyre themelore.*

**Në vlerësimin e treguesve të performancës, qëllimi konsiderohet i realizuar 75% gjate 8- mujorit 2026 nga planifikimi.**

Në realizimin ne kete nivel të tij ka ndikuar puna e bërë gjatë periudhës raportuese nga ana e stafit të KSHB, duke mbajtur gjithmonë parasysh dhe garantuar interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, është bashkërenduar puna me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e birësimit, agjencitë ndërmjetësuese për birësimet ndërvendase si dhe me të gjitha institucionet e përkujdesit social me qëllim realizimin e proceseve birësuese në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

Në funksion të këtij qëllimi, programi ynë ka patur dy objektiva për realizim, si më poshtë:

1. ***Objekti 1.1*** – Përfundimi me sukses i dhënies për birësim çifteve shqiptare dhe atyre të huaja, <u>të 15 fëmijëve</u> gjatë periudhës Janar- Gusht 2026. ***Ky objektiv deri në fund të muajit gusht 2026 është realizuar 15 nga 20 rastet e planifikuara për vitin, ose 75% e planit vjetor*** Gjatë periudhës raportuese, KSHB ka shqyrtuar brenda afateve ligjore të gjitha kërkesat për birësim.
2. ***Objekti 1.2*** – Pajisje elektronike të blera dhe Pajisje per zyra. Blerja e pajisjeve elektronike. Për këtë objektiv është përfunduar procedura e prokurimit gjatë periudhës raportuese, ndërsa realizimi financiar deri më 31.08.2026 është 0 lekë. Likuidimi parashikohet të pasqyrohet në muajin shtator 2026.".

Sipas Anekseve nr.3 Raporti I performances së produkteve të programit dhe nr.3/1 Raporti performances së produkteve të programit sipas artikujve si më poshtë:

ANEKSI nr.3 Raporti i performancës së produkteve të programit

Periudha e Raportimit 08-2026

në/lekë

| Emri i Grupit | Ministria e Drejtësisë | Kodi i grupit | 14 |
|---|---|---|---|
| Emri i | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | Kodi i programit | 01160 |

| Kodi i Produktit | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Viti paraardhës | | | Periudha Rapotuese | | | Periudha Rapotuese | | | Periudha Rapotuese | | | Deviacioni i Kostos për Njësi | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Sasia Faktike (Viti paraardhës) | Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhes) | Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës) | Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) | Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor | Kosto per Njesi (sipas planit Fillestar te vitit | Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent) | Shpenzimet (sipas /nplanit te rishikuar te vitit korent) | Kosto per Njesi(sipas /nplanit te rishikuar te vitit korent) | Sasia Faktike (ne /nfund te vitit korent) | Shpenzimet Faktike /n(ne fund te vitit korent) | Kosto per Njesi Faktike n/(ne fund te vitit korent) | 13=(12)-(3) | 14=(12)-(6) | 15=(12)-(9) |
| | | | (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) | (7) | (8) | (9) | (10) | (11) | (12) | (13) | (14) | (15) |
| **Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të** | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 91404AA | Kërkesa për birësim të shqyrtuara | Numër | 26 | 14,875,532 | 572,136 | 20 | 19,110,000 | 955,500 | 20 | 24,560,000 | 1,228,000 | 15 | 13,909,884 | 927,326 | 355,190 | -28,174 | -300,674 |
| 18AR302 | Pajisje elektronike të blera | Numër | 1 | 86,384 | 86,384 | 1 | 100,000 | 100,000 | 2 | 200,000 | 100,000 | 0 | 0 | 0 | -86,384 | -100,000 | -186,384 |
| 18AR303 | Paisje per zyra | Numër | 0 | 0 | 0 | 1 | 100,000 | 100,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | -100,000 | 0 |
| T | Total | | | 14,961,916 | | | 19,310,000 | | | 24,760,000 | | | 13,909,884 | | | | |
| **Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (Nga kapitulli 06)** | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Periudha e Raportimit 08-2026

Aneksi 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve

| Kodi i Ministrisë | Kodi i Programit | Emërtimi i Programit | Kodi I Produktit | Emërtimi i Produktit | Tipi i Buxhetit | Sasia | Artikujt buxhetore | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Total | 230 Shpenzime Kapitale te Patrupëzuara | 231 Shpenzime Kapitale te Trupëzuara | 600 Pagat | 601 Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore | 602 Mallra dhe Shërbime | 603 Subvecinet | 604 Te Tjera Transfer.Korrente Brendshme | 605 Transfer. Korrente te Huaja | 606 Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individët |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 91404AA | Kërkesa për birësim të | Plani fillestar | 20 | 19,110,000 | 0 | 0 | 13,390,000 | 2,280,000 | 3,440,000 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 91404AA | Kërkesa për birësim të | Plani i rishikuar | 20 | 24,560,000 | 0 | 0 | 17,990,000 | 3,030,000 | 3,416,000 | 0 | 0 | 0 | 124,000 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 91404AA | Kërkesa për birësim të | Fakti | 15 | 13,909,884 | 0 | 0 | 10,171,910 | 1,674,781 | 2,049,393 | 0 | 0 | 0 | 13,800 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 18AR302 | Pajisje elektronike të | Plani fillestar | 1 | 100,000 | 0 | 100,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 18AR302 | Pajisje elektronike të | Plani i rishikuar | 2 | 200,000 | 0 | 200,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 18AR302 | Pajisje elektronike të | Fakti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 18AR303 | Paisje per zyra | Plani fillestar | 1 | 100,000 | 0 | 100,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 18AR303 | Paisje per zyra | Plani i rishikuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 18AR303 | Paisje per zyra | Fakti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | Totali i shpenzime buxhetore | Plani fillestar | | 19,310,000 | 0 | 200,000 | 13,390,000 | 2,280,000 | 3,440,000 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | Totali i shpenzime buxhetore | Plani i rishikuar | | 24,760,000 | 0 | 200,000 | 17,990,000 | 3,030,000 | 3,416,000 | 0 | 0 | 0 | 124,000 |
| | | | | Totali i shpenzime buxhetore | Fakti | | 13,909,884 | 0 | 0 | 10,171,910 | 1,674,781 | 2,049,393 | 0 | 0 | 0 | 13,800 |

Sa i takon realizimit të produkteve për secilin objekt, situata paraqitet si në vijim:

Objekti 1.1 Ka patur një produkt të parashikuar:

**Produkti 91404AA** – Kërkesa për birësim të shqyrtuara. ***Ky produkt është përmbushur në masën 57 %*** krahasuar me planin.

| | |
|---|---|
| Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor te vitit 2026) | 20 |
| Sasia faktike (në fund të 8/mujorit të pare te vitit 2026) | 15 |

Megjithëse realizimi financiar i përgjithshëm është 56 %, realizimi fizik i produktit kryesor (kërkesa për birësim të shqyrtuara) ka arritur në 75 % të planit, çka tregon se kostot fikse te realizimi fizik të produktit kanë arritur përdorimin me eficence te burimeve buxhetore në perudhën 8-mujore 2026 dhe optimizim të shpenzimeve në raport me performancën e arritur.

***Objekti 1.2*** – Pajisje elektronike të blera dhe Pajisje zyre. Ka patur dy produkte të parashikuara.
**Produkti 18AR302** – Pajisje elektronike të blera. ***Për këtë produkt u realizua procedura e prokurimit.***
**Produkti 18AR303** – Pajisje zyre. ***Për këtë produkt është bere transferim fondi ne produktin 18AR302.***

Birësimet gjate 2026 janë 15 në total nga të cilat janë mbartur edhe femijët e ardhur nga vitet e mëparshme. Për vitin 2025 janë birësuar 26 fëmijë. Për vitin 2024 janë birësuar 12 fëmijë.

**Qëllimi i KSHB: Bazuar në treguesit e realizimit të objektivave dhe produkteve të programit, qëllimi strategjik i programit konsiderohet i realizuar, për 8-mujorin pasi janë trajtuar të gjitha kërkesat e paraqitura dhe janë përfunduar procedurat për 15 fëmijë brenda afateve ligjore. duke përjashtuar rastet kur fëmijët janë me probleme shëndetsore.**

Shpenzimet për këto produkte janë planifikuar me fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit të vitit 2026. Po ashtu, të gjithë treguesit e performancës në nivel objektivi janë realizuar.

Nga analiza e realizimit të qëllimit, objektivave dhe produkteve rezulton se, gjatë periudhës janar–gusht 2026, KSHB ka vijuar përmbushjen e politikës së programit. Institucioni është angazhuar maksimalisht për vijimin e detyrave të parashikuara, duke përmbushur ne vazhdim qëllimin dhe objektivin kryesor të KSHB, që është shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikantëve birësues, dhe realizimi i proceseve birësuese për të gjithë fëmijët dosjet e të cilëve janë depozituar ne KSHB, duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijëve.

**Theksojmë se, gjatë periudhës Janar- Gusht 2026 për institucionin tonë nuk paraqitet asnjë detyrim i prapambetur i krijuar rishtazi apo i mbartur**. Të gjitha shpenzimet janë kryer në kohë dhe janë përballuar me fondet nga Buxheti i Shtetit.

## 5. PROJEKTET KAPITALE

Sqarojmë se, KSHB nuk ka parashikuar dhe realizuar projekte të mëdha investimi kapitale me financim të brendshëm apo të huaj gjatë vitit 2026. Gjatë periudhës raportuese janë parashikuar vetëm dy investime

kapitale me vlerë të kufizuar, i lidhur me blerjen e pajisjeve elektronike dhe pajisje në zyra (artikulli 231), sipas planifikimit buxhetor vjetor. Gjithashtu, institucioni nuk siguron të ardhura jashtë limitit dhe, për rrjedhojë, nuk ka financuar asnjë shpenzim nga ky burim të ardhurash gjatë periudhës Janar–Gusht 2026.

## 6. NDRYSHIMET NË BUXHET

Me shkresën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Drejtësisë Nr.491/2 prot dat 13.02.2026"Dërgohet miratimi i transferimit te fondit per vitin 2026"", për institucionin tonë është miratuar detajimi i buxhetit për fondin e veçantë prej 100.000 lekë. Gjithsej janë alokuar fonde prej 100.000 lekësh, në llogarinë 606 prej 100.000 lekë, Ministria e Drejtësise me shkresën Nr.4557 prot dat 28.07.2026" Mbi zbatimin e aktit normativ Nr.2, datë 30.06.2026 për shpenzimet korrente"solli ndryshime me shtesa në llogarinë ekonomike 600 "Paga" prej 4,600,000 lekë dhe në llogarinë ekonomike 601 "Sigurimeve shoqerore e shendetesore" 750,000 leke. Plani i rishikuar për programin është 24,760,000 lekë.

Ndryshimet e buxhetit(shtesat) paraqiten për periudhën raportuese në formë tabele, sipas llogarive ekonomike si në vijim:

| Përshkrimi | Totali | Llog. 600 | Llog. 601 | Llog. 602 | Llog. 606 | Llog. 231 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Buxheti (Plan) | 19,310,000 | 13,390,000 | 2,280,000 | 3,440,000 | | 200,000 |
| Buxheti (ndryshime në plan) | 100,000 | | | -24,000 | 124,000 | |
| Ndryshimet në buxhet (Plani i rishikuar) | 5,350,000 | 4,600,000 | 750,000 | 0 | 0 | 0 |
| Plan thesari 12-mujor | 24,760,000 | 17,990,000 | 3,030,000 | 3,416,000 | 124,000 | 200,000 |
| Realizimi fakt | 13,909,884 | 10,171,910 | 1,674,781 | 2,049,393 | 13,800 | 0 |

Realizimi I buxhetit të Institucionit tonë për periudhën Janar- Gusht 2026 është 13,909,884 lekë, krahasuar me buxhetin total të vitit 24,760,000 lekë Niveli i realizimit përfaqëson 56 % të planit vjetor, me një diferencë prej 10,850,116 lekë nën plan.

## 7. PËRFUNDIME

Gjatë periudhës raportuese nuk janë evidentuar risqe buxhetore që cenojnë realizimin e programit. Risqet kryesore të identifikuara lidhen me vonesat procedurale në prokurime, për të cilat janë marrë masa organizative për minimizimin e tyre në periudhat pasardhëse gjate vitit 2026.Të ardhurat sekondare të sigururara nga tarifat e birësimit gjatë periudhës Janar- Gusht 2026 nuk janë përdorur si burim financimi për shpenzime, por janë derdhur 100% në Buxhetin e Shtetit. Të ardhurat e Institucionit tonë për periudhën 8-mujore janë 574,010 lekë. Gjatë periudhës Janar- Gusht 2026, institucioni ynë, në kuadër të monitorimit të buxhetit, ka përgatitur dhe Evidencën e shpenzimeve. përkatëse.

**.Ky raport publikohet ne https://kshb.gov.al/transparenc/ rubrika Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të KSHB*

| HARTOI: | MIRATOI: |
|---|---|
| **SPECIALIST (BUXHET - FINANCË)** | **KRYETAR** |
| **Marcela Kocaj** | **Alma Laci** |